



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 02 datë 31.01.2018

Për autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e subjektit mbështetës për mirëmbajtjen e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave

Në mbështetje të nenit 25 gërma “d”, të nenit 26 pikat 4 dhe 5, të nenit 42 pika 7, të nenit 44 pika 2 të Ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, si dhe të neneve 6, 9, 27 pikat 1, 2 dhe 3, dhe 28 pika 1 të Rregullores nr. 3762, datë 18.7.2016 “Për kompensimin e depozitave të siguruara”, bazuar në propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e subjektit mbështetës për mirëmbajtjen për një periudhë tre vjeçare të Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.
2. Të miratojë fondin limit prej 4.630.000 (katër milion e gjashtëqind e tridhjetëmijë) lekë pa TVSH, për çdo vit kontraktor, për përzgjedhjen e subjektit mbështetës për ofrimin e shërbimit me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”.
3. Efektet financiare për qëllim të zbatimit të kësaj procedure mbulohen nga buxheti i Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar